



# PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit  
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal  
i Zi - Kosovë 2014- 2020

## Dhjetor 2019

FOTO: FATKEQËSITË NATYRORE NUK NJOHIN KUFINJ

PËRMBAJTJA

Edicioni i gjashtë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë\* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

### Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

### Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

\* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- »»» Bashkëpunimi ndërkufitar dhe asistencë e përbashkët në përgjigje të fatkeqësive natyrore.....2
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....3
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë.....8
- »»» Takimi i 9-të Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Plavë ..... 10
- »»» Katër trajnime mbi Ciklin e Menaxhimit të Projekteve u mbajtën në zonat e programeve.....10

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

bashkimi evropian  
balezet domodoshmerisht mendimet e



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



**MNE – ALB**

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



**MNE – KOS**

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020



## Bashkpunimi ndërkufitar dhe asistenca e përbashkët në përgjigje të fatkeqësive natyrore

Projekti *Fatkeqsitë Natyrore nuk njohin kufinj* zbatuar nga FORS në Mal të Zi në bashkpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Drejtorinë e Emergjencave dhe Prefekturën Shkodër synon të arrij përmirsimin e mbrotjes së njëzëve dhe zonave nga fatkeqsitë natyrore, kryesisht nga përmbytjet, nëpërmejt rritjes së kapaciteteve, ndërgjegjsimit dhe bashkpunimit ndërkufitar në reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive. Për të patur një ide më të qartë mbi ndikimin e aktiviteteve të projektit ndaj përfituesve dhe atyre që e zbatojnë, ne i kontaktuam dhe i bëmë disa pyetje mbi projektin dhe në përgjithësi mbi programin e BNK-së.

**Tamara Todoroviq**, nga organizata FORS Montenegro duke komentuar mbi projektin dhe BNK deklaroi se "*Bashkpunimi me fqinjët kontribuon në përforcimin e marrëdhënieve, mundëson shkëmbimin e eksperiencave, praktikave më të mira dhe bën bashkë njëzë dhe komunitete lokale nga të dyja anët e kufirit. Ne mendojmë se një shembull i mirë i gjithë kësaj mund të shihet në zbatimin e projekteve të përbashkëta lidhur me mbrotjen nga fatkeqsitë natyrore dhe të tjera. Konkretisht këto projekte përveç përfitimeve në rritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjsimit, sjellin edhe përmirsimin e bashkpunimit ndërmjet njëzëve dhe shërbimeve të emergjencës që marrin pjesë aktive në këtë projekt, që në fund do të rezultojë me aftësimin dhe gadishmërinë e tyre për të ndihmuar njëri-tjetrin në situata emergjence.*"




**Andris Tufi**, oficeri i projektit për Prefekturën Shkodër, mendon që "duke punuar së bashku, këto rajone mund të identifikojnë dhe adresojnë bashkarisht sfida të veçanta dhe mundësitë e ofruara nga kufiri ndërmjet tyre." *Gjithastu ai deklaroi që "BNK në përgjithësi ndihmon në përmirsimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve pjesëmarrëse e si rrjedhojë edhe organizatave dhe insitucioneve të përfshira në këto iniciativa. Fondet e akorduara nga BE për bashkpunime të tilla kontribuojnë në stabilitetin dhe*



*prospëritetin e zonave kufitare të BE-së dhe forcon më tej kontaktet njëzë me njëzë dhe rrjetin e komuniteteve lokale. Për më tepër ai deklaroi se programi BNK kontribuon në krijimin e një identiteti të përbashkët ndërkufitar dhe lehtëson gjenerimin e kapitalit social, besimit dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e kufirit."*

**Ranko Paviqeviq**, nga Shërbimi i Mbrotjes dhe Shpëtimit në Podgoricë, si një ndër përfituesit e projektit, deklaroi se "*njohuritë e përfuara gjatë aktiviteteve të ndryshme të projektit kontribuojnë në hartëzimin real të fatkeqësive si në zonën ku jetoj unë ashtu edhe në vendin fqinj. Gjatë trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera unë takova kolegë nga rajoni më të cilët do të komunikoj dhe bashkpujoj, do marr vendime dhe vepra më lehtë në rast të ndërhyrjeve në terren në vendin tim ose të tyre. Njohuri të rëndësishme u morën, të cilat më pas mund të aplikohen në shërbimin ku unë punoj ndërkohë që unë jam motivuar për edukim të mëtejshëm në fushën e shpëtimit." Ai theksoi që "në rast të fatkeqësive të mëdha natyrore asnjë sistem i vetëm nuk mund t'u përgjigjet plotësisht sfidave në terren, as vendet e zhvilluara me fuqi ekonomike të konsiderueshme, prandaj forcimi i kapaciteteve për përgjigje ndaj këtyre dukurive në mendimin tim e bëjnë bashkpunimin ndërkombëtar dhe asistencen reciproke të domosdoshme.*"



**Angel Marçev**, nga Instituti Hidrometeorologjik dhe Sismologjik i Malit të Zi theksoi që konkretisht "*Departamenti i Modelimit Numerik, Satelitor dhe Meteorologjik përfitoi pajisje kompjuterike të cilësisë së lartë- HPE DL360 Gen9 8SFF CTO Server. Me këto pajisje, produktet e përditshme të modeleve operacionale janë të disponueshme për të gjithë përdoruesit në intervale kohore tashmë të përgjysmuara. Stabiliteti i punës i modeleve operacionale për parashikimin e motit është në një nivel të lartë tashmë dhe detyrat e përditshme kryhen më shpejt dhe janë më të sigurta. Për më tepër, nëpërmejt trajnimeve të organizuara nga projekti ne kemi përmiruar në mënyrë të konsiderueshme njohuritë, aftësitë dhe kompetencat ashtu si dhe bashkpunimin me kolegët nga Shqipëria, që më pas do t'a orientojë drejt përmirimit të kapaciteteve të institucioneve tona dhe një pune me më shumë efikasitet. Sipas mendimit të tij, projektet ndërkufitare mund të ndihmojnë në frocimin e kapaciteteve në pajisje teknologjike, trajnimin e punonjësve dhe vazhdimin e përmirimit të bashkpunimit me kolegët nga vendet e tjera nëpërmejt iniciativave të përbashkëta.*"

"*Trajnimet ndërkufitare ishin shumë të rëndësishme për mua dhe kolegët e mi që moren pjesë pasi ne patëm mundësi të takojmë dhe punojmë me kolegë nga vendet fqinjë" tha Edison Suma*, një zjarrfikës nga Bashkia Shkodër. Gjithastu ai deklaroi se ata patën rastin të trajnohen nga trajnerë shumë të specializuar ndërkombëtar, nga të cilët, mësuar praktikisht më të mira të shpëtimit, që do t'i ndihmojnë në punën e përditshme. Ai është i mendimit që partneriteti për bashkpunimin ndërkufitar merr një kohë të caktuar për t'u maturuar ndërkohë që krijimi i strukturave të duhura dhe zbatimi i programit janë procese për tu mesuar nga të gjitha pjesëmarrësit". Zbatimi i programeve kërkon përpjekje të përbashkëta të të gjithë aktoreve në mënyrë që programi BNK-së të vazhdojë të arrijë rezultate të plota nga ky bashkpunim intensiv që do të materializohet në vitet në vijim.



## Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

### Projekti i përfunduar “Ana Femërore e cilësisë”

Në kuadër të projektit *Ana Femërore e cilësisë* zbatuar nga Komuna e Ulqinit, OJQ MogUI, Qendra UET dhe Bashkia Mirditë, u organizua panairi i dytë në Mirditë, si dhe Konferenca përmbyllëse në Ulqin. Këto dy aktivitete shënuan edhe mbylljen e projektit. Më saktë, panairi me produkte lokale “Fest-Mirdita 2019” u organizua në sheshin Abat Doçi në 25 – 26 Shtator të vitit 2019.



Panairi promovojë produktet e grave vendase që jetojnë e punojnë në Mirditë dhe qytetarët patën rastin të familiarizohen me produktet dhe prodhuesit lokal dhe zonat ndërkufitare.



Ndërkohë konferenca përmbyllëse u organizua në Hotel Mediteran në Ulqin duke shënuar kështu edhe mbylljen e projektit 18 mujorë.

Pas prezantimit të rezultateve të projektit dhe kontributit në punësimin e grave, veçanërisht atyre nga zonat rurale, duke shrytëzuar potencialin agrikulturorë të të dy vendeve, pjesëmarrsit patën rastin të shijojnë edhe produktet tradicionale të përgatitura nga gratë e Mirditës dhe Ulqinit dhe të shohin disa nga rezultatet e projektit.



### Ligjerata dhe takime të organizuara me komunitetet lokale në Berane dhe Shkodër

Projekti *Ishujt e Gjelbërt* organizoi dy punëtori me 64 pjesëmarrës nga bashkitë, ndërmarrjet e mirëmbatjes dhe policisë bashkiake. Punëtorite u organizuan në Shkodër dhe Berane dhe ishin fokusuar tek legjislacioni kombëtarë dhe i BE-së në lidhje me mjedisin, veçanërisht detyrimet e përshkuara me ligj dhe zbatimin e tyre, përgjegjësitë për prodhuesit e mbetjeve në sektorin e mjedisit dhe optimizimi i kostove për menaxhimin e mbetjeve.



Gjithashtu pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë rëndësinë e aktorëve lokal për menaxhimin e mbetjeve, problemet dhe shqetësimet me të cilat ndeshen në praktikë dhe zgjidhjet e mundshme.



Takimet me përfaqësues lokal në Berane (Novo Naselje, Park dhe Pesca) u mbajtën në Shtator dhe Tetor të vitit 2019. Gjatë këtyre takimeve, qytetarët patën mundësinë të flisnin me përfaqësuesit e projektit, ndërmarrjes së mirëmbatjes, policisë bashkiake mbi qasjet teknike “E lagësht – e thatë” dhe pilot projektin, të cilat do të mundësojnë ndarjen e mbetjeve në kazan të dedikuar.

Në datat 2 dhe 8 qershor të vitit 2019 projekti u prezantua në takimin e përvitshëm "Dita e Turizmit Malor" e organizuar nga bashkia Malësi e Madhe dhe VIS Albania si dhe në panairin Eko-Biodiversiteti. Këto dy evente rritën ndërgjegjshimin mbi rëndësinë e mbrotjes së natyrës dhe ambientit dhe u fokusuan në përfitimet e depozitimit të selektuar të mbetjeve. Gjithashtu, u organizuan aktivitete ekologjike për pastrimin e mjedisit me përfshirjen e fëmijëve dhe studenteve. Këto aktivitete ishin të rëndësishme për promovimin e projektit dhe u ndoqën nga 100 pjesëmarrës.



### Aktivitete të organizuara në kuadër të projektit Ruatja e Peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi

Gjatë muajit nëntor të vitit 2019 në kuadër të këtij projekti filloi adaptimi i hapësirës që do përdoret si Muze etnografik. Ky muze do vendoset në oborrin e shkollës në Lubnicë, Berane. Përshtatja e ambientit për muzeun është bërë duke përdorur metoda dhe material tradicional.



Më hollësisht, ky proces delikat është kryer nga zejtari Tatko Raiçeviq, nga fshati i Pracevac afër Berane i cili është njëri nga dy njerëzit në këtë zonë që akoma vazhdon të punojë me tjegulla dërrase (shindra).

Gjithashtu në të njëjtin projekt një seri publikimesh u prodhuan me qëllim ruatjen dhe mbrotjen e peisazhit kulturor në rajonin BNK-së.

Studimet e prodhuara përfshijnë disa të dhëna specifike, teknike dhe arkitekturore nga rajoni i Shkodrës dhe nga komunat Berane, Petnicë, Andrijevica, Plavë dhe Guci.



### FAKTE – TJEGULLA DËRRASE (SHINDRA)

Tjegullat prej dërrase zakonisht bëhen me punim dore, sipërfaqja është e ndarë dhe ulluqe speciale duhen bërë në mënyrë që uji të rrjedh poshtë nga çatia.

## Konferenca Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqsitë natyrore dhe Rëndësia e BNK-së

Në kuadër të projektit *Fatkeqsitë Natyrore nuk njohin kufinj* FORS në Maltë Zi në bashkpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Malit të Zi, Drejtorinë e Emergjencave dhe Prefekturën Shkodër organizuan një konferencë me temë "Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqsitë Natyrore dhe Rëndësia e bashkpunimit BNK-së".

Kjo konferencë u organizua në Podgoricë me datë 14 – 15 Nëntor të vitit 2019 me qëllim që të ndihmojë shkëmbimin e eksperiencave, mendimeve, praktikave të mira dhe mësimëve në fushën e reduktimit të pasojave nga fatkeqsitë natyrore si dhe të kontribuoj në informimin e popullatës dhe grupeve target për rëndësinë e bashkpunimit ndërkufitar.



Konferenca mbledhi bashkë përfaqësues nga institucionet dhe shërbimet e mbrotjes dhe shpëtimit, organizata nga shoqëria civile, autoritetet lokale dhe kombëtare, media, partnerët e projektit, etj. Takimi u hap me fjalën e Z. **Mevludin Nuhoxhiq**, Ministër i Punëve të Brendshme të Malit të Zi, **Marija Vukçević**, Drejtore e Përgjithshme e drejtorisë për Financimin dhe Kontraktimin të fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, **Ivana Glisheviq Gjuroviq**, Koordinatore Kombëtare e programit IPA në Zyrën për Integrimin Evropian të Malit të Zi, **Donata Von-Sigsfeld**, Menaxhere Programi për Bashkpunimin Territorial në Delegacionin e BE-së në Malin e Zi, **Çesk Millja**, Prefekti i Shkodrës, dhe **Veselin Shturanoviq**, Drejtor Ekzekutiv i FORS Montenegro.



### FAKTE – KORNIZA SENDAI PËR REDUKTIMIN E RISKUT NGA DIZASTRAT

"Korniza Sendai për Reduktimin e Riskut nga Dizastrat 2015-2030 ishte marrëveshja e parë e madhe pas axhendës së Kombeve të Bashkuara 2015 që i jep shteteve anëtare orientim dhe masa konkrete për të mbrojtur arritjet e zhvillimit nga rreziku i fatkeqësive. Ajo është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe advokon për:

Reduktimin thelbësorë të rrezikut nga fatkeqsitëdizastrave dhe humbjes së jetëve njëzore, gjësë së gjallë dhe shëndetit, asetëve ekonomike, fizike, kulturore dhe mjedisore të njerëzve, bizneseve, komuniteteve dhe vendeve.

Ajo njeh dhe ngarkon shtetet me rolin primarë në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësive por kjo përgjegjesi duhet ndarë me aktorë të tjerë përfshirë qeverisjen lokale, sektorin privat dhe palët e tjera të intresuara" – pika kryesore e Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqsitë.

Gjatë konferencës, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bashkpunimit ndërkufitar, rajonal dhe ndërkombëtar në reduktimin e rrezikut nga fatkeqsitë, vazhdimin e përmirësimeve në kapacitetet teknike dhe njerëzore, zbatimin e masave të Kornizës Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga FatkeqsitëDizastrat, aksionet parandaluese, edukimin e popullatës mbi rrezikun e mundshëm, miratimin e dokumentave strategjik dhe planeve përkatëse, përfshirë edhe zbatimin e tyre të plotë, përfshirjen aktive të të gjithë institucioneve, organizatave dhe qytetarëve, etj. Përfundimet e konferencës mund të lexohen në linkun [këtu](#).

### Punëtori të orgaizuar në Bushat, bashkia Vau i Dejës, Shqipëri

Bashkia e Petnjicës, Orgaizata Kombëtare e prodhuesve të Mjdrës, shkolla e mesme Petnjica, shkolla e mesme profesionale kombëtare "Ndre Mjeda" dhe OJF COSPE Shqipëri, si partner të projektit *Të rinjtë Malazez dhe Shqiptar për mbjedhjen e Mjdrës* organizuan një punëtori për prodhuesit lokal të mjdrës në Bushat, bashkia Vau i Dejës, Shqipëri.

Gjatë muajit Shtator dhe Tetor të vitit 2019, 16 punëtori u mbajtën për pjesëmarrësit në Bushat për të trajtuar çështje të tilla si mbrotja e mjdrës, puna për mbjedhjen e mjdrës, proceset e saj, standardizimi i frutit të mjdrës, procesimi i mjdrës për komposto dhe lëng, prodhimi organik, rregullat e prodhimit dhe cilësisë së ushqimit, puna për prodhimin e mjdrës dhe kontrolli i cilësisë.



### FAKTE – MJEDRA

Mjedra piqet në fund të muajit qershor ose 25-30 dite nga çelja e lules. Në mënyrë që ajo të prodhoj frute duhet të mbillen ndërmjet muajit nëntor dhe mars.

Klikoni [këtu](#) për të parë prodhuesit e Mjadrës gjatë procesit të mbjelljes në Petnjicë, Mal i Zi.



### Promovohet projekti "Turizëm miqësor për fëmijët"

Me datë 25 tetor të vitit 2019, përfaqësuesit e OJQ ADP ZID bashkë me partnerët e tyre Qendra Fëmijet Sot nga Shqipëria, mbajtën një takim për vlerësimin e aktiviteteve dhe progresit të projektit *Turizëm miqësor për Fëmijët*.

Pjesa e parë e takimit ishte fokusuar në progresin e projektit dhe aktivitetet e realizuara, e ndjekur më pas me një diskutim mbi rëndësinë e dizajnit, efikasitetin, ndikimin, qëndrueshmërisë së projektit dhe aktiviteteve të tij dhe në përfundim ndikimin që duhet të ketë në popullsinë lokale në zonat ndërkufitare.



Takimi përfundoi me një diskutim mbi vështirësitë dhe problemet në lidhje me fazën finale të zbatimit të projektit, si dhe masat korrektive në lidhje me menaxhimin e projektit dhe përgatitjen e hapave për fazat e tjera në vijim. Gjithashtu janë organizuar edhe takime promovuese me qëllim të ndërgjegjësimit të publikut të gjerë, për të siguruar prezantimin e inovacioneve në komunitetet e bazuara tek turizmi në rajonin ndërkufitar. Aktivitete promovuese u mbajtën në Rozhajë me datë 15 gusht dhe në Podgoricë me datë 1 tetor të vitit 2019.




Mund të ndiqni faqen e facebook të projektit "Turizëm Miqësor për Fëmijët" duke klikuar [këtu](#).

### Receta të mbledhura dhe publikuara

Me qëllim krijimin e një oferte rajonale turistike ndërkufitare bazuar tek gastronomia, u identifikuan dhe mbledhën receta tradicionale në kuadër të aktiviteteve të projektit *Kuzhina Lokale si një Ofertë Turistike në rajonin ndërkufitar*. Tani recetat e standardizuara janë gati të përdoren nga hotelet lokale dhe restorantet, si dhe mund të disponohen nga të gjithë të interesuarit. Mund të shkarkoni librin me receta kuzhine Gorska trpeza [këtu](#).





Mund të shkarkoni librin me receta nga rajoni Pukë [këtu](#).

### Gërmime në një kishë 1500 vjeçare në Hot të Malësisë së Madhe

Projekti *Rritja e Bashkëpunimit - nga Antikitetet Kristiane drejt përmirimit të turizmit* ka vijuar të ketë rezultate cilësore në zonën ndërkufitare.

Më hollësisht, konferenca e dytë e projektit u mbajt me datë 27 Shtator të 2019 në Shkodër (Shqipëri) në Bazilikën Kristiane të Hotit.



Gjurmë të një kisha Paleo-Kristiane që daton në shekullin e 5-të janë zbuluar në Hot gjatë gërmimeve arkeologjike. Arkeologu **Gëzim Hoxha** prezantoi veçanëritë e kësaj kisha, gurët simbolikë që janë përdorur 15 shekuj më parë dhe faktin se kjo kishë është ndër të parat e ndertuara në territorin e Shqipërisë dhe Ballkanit.

Ky event u përqendrua në prezantimin e rezultateve të gërmimit të kishës mbi 1500 vjeçare në Hot të Malësisë së Madhe. Koordinatori i projektit, përfaqësues i Dioqezës Budimlje Nikshiq, dhjaku **Konstatnin Dojiq** deklaroi se trashigimia kulturore fetare duhet të konsiderohet në një kontekst bashkëkohor dhe qellimi i këtij projekti është përdorimi i zbulimeve arkeologjike për të zhvilluar turizmin e zonës.

Gjurmë të një kisha Paleo-Kristiane që daton në

shekullin e 5-të janë zbuluar në Hot gjatë gërmimeve arkeologjike. Arkeologu **Gëzim Hoxha** prezantoi veçanëritë e kësaj kisha, gurët simbolikë që janë përdorur 15 shekuj më parë dhe faktin se kjo kishë është ndër të parat e ndertuara në territorin e Shqipërisë dhe Ballkanit.



#### FAKTE – KISHA në HOT

Ndër të tjera, arkeologu **Gëzim Hoxha** tha që ishin banoret e zonës si dhe pronarët e tokës ku ndodhet kisha ata që kanë ruajtur reliket fetare gjatë kohës së vështirë të komunizmit.

## Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

### Janë mbajtur punëtori për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Ekipi i projektit *Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave* ka organizuar trajnim për ngritje të kapaciteteve për punonjësit e ndërmarrjeve lokale të shërbimeve publike në zonat e targetuara. Punëtorja e parë është mbajtur në Gjakovë, Kosovë më 11 Shtator 2019.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjojnë prezantime përkatëse për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Përkatësisht, në kuadër të këtij projekti, do të organizohen gjithsej 30 punëtori me grupe të targetuara siç janë punëtorët e sektorit publik, mësuesit, nxënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme.



### Vetëpunësimi i të rinjve dhe ndërmarrësia sociale

Në kuadër të projektit të zbatuar nga OJQ Asociacioni për Prosperitet Demokratik - ADP ZID nga Mali i Zi, OJQ Lens dhe Qendra Liberal Demokratike dhe Qendra për Aftësi Kreative janë duke vazhduar fushatën promovuese për promovimin e konceptit të inovacionit social dhe metodave në internet si një nga mundësitë për punësim. Përkatësisht, pas gjashtë punëtorive që janë organizuar në Berane, Rozhajë, Podgoricë, Pejë, Istog dhe Deçan janë publikuar disa thirrje për prokurim, për trajnimin e programeve mësimore, video materialeve dhe marrjen me qira të *Hackerspace-it*.



## Hartëzimi i resurseve agrobujqësore ka përfunduar

Në kuadër të projektit *Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës*, ku partnerët e projektit pas hartëzimit të burimeve agrobujqësore në komunat e targetuara në Mal të Zi dhe Kosovë, hartuan dhe shpërndanë "Doracakun për start-up fermerët". Për më tepër, vizitat dhe trajnimet në terren janë ofruar fermerëve që janë zgjedhur për të marrë pjesë në trajnimet arsimore në Mal të Zi dhe Kosovë. Promovimi i punësimit në bujqësi po bëhet në shkollat e mesme dhe përmes agjencive lokale të punësimit në Berane, Andrijevicë, Plavë dhe Deçan.



Në Komunën e Deçanit (Kosovë), është themeluar dhe pajisur qendra e trajnimit dhe do të jetë në dispozicion për nevojat e fermerëve, si dhe për ushtrime praktike gjatë trajnimeve. Për më tepër, trajnimet edukative janë kryer në Kosovë.



Deri më tani, pjesëmarrësit në Kosovë patën mundësinë për të rritur njohuritë e tyre teorike dhe praktike përmes moduleve trajnuese mbi "Bioteknologjinë", "Riprodhimin e gjedhit dhe mbarështimin artificial" dhe "Ushqimin për lopët e qumështit dhe praktikën më të mira të ushqimit". Në periudhën në vazhdim, qendra e trajnimit do të themelohet edhe në Mal të Zi dhe gjithashtu do të mbahen module trajnimi për fermerët malazez.





## Muaji i ndërgjegjësimit mbi kancerin e gjirit

Në kuadër të projektit *Vepimet ndër-kufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues*, OJQ FORS nga Mali i Zi zhvilloi një seri aktivitete. Përkatësisht, spote promovuese TV u pergaditen dhe filluan me transmetim dhe një fushatë e gjerë u përfundua në kuadër të shënimit të *Tetorit si Muajt të Ndërgjegjësimit mbi Kancerin e Gjirit*. Fushata promovuese synonte rritjen e mbështetjes dhe tërheqjen e vëmendjes së publikut të gjerë për rëndësinë e zbulimit dhe trajtimit të hershëm të kësaj sëmundje.

Versioni në gjuhen malazeze mund të shihet [këtu](#).

Versioni në gjuhen shqipe mund të shihet [këtu](#).

Fushata për parandalimin e hershëm u organizua për gratë nga Andrijeviça, Berane, Bijelo Polje, Gucija, Petnjica, Plava, Kolashini, Mojkovaci, Rozhajaja në Mal të Zi dhe nga Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Gjakova në Kosovë.

Fushata u zbatua së bashku me qendrat shëndetësore në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera që mund të ndihmojnë në mobilizimin e grave, siç janë media, autoritetet lokale, kompani, OSHC, etj. Përveç kësaj, *Broshurat mbi Shëndetin Riprodhues* u pergaditen si në gjuhen [malazeze](#) ashtu edhe në gjuhën [shqipe](#).



## Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike

Projekti *Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike* zbatohet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulmtimin e Zogjve, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), Shërbimi i Shpëtimit në Mal të Zi dhe Shoqata Bjeshkatore "PASHTRIKU". Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve brenda projektit vazhduan në shtator të vitit 2019. Përkatësisht, një punëtori e përbashkët me ofruesit lokalë të turizmit në të dy anët e kufirit u organizua në Plavë, Malë të Zi. Punëtorja kishte për qëllim të bashkojë palët e interesuara nga Mali i Zi dhe Kosova në mënyrë që të nxjerrin përfundime dhe bashkërisht të identifikojnë vendet dhe shërbimet e ofruara në zonë dhe të krijojnë një paketë turistike.

Punëtorja u udhehoq nga **Tadeja Levkosek** nga Sllovenia e cila ka përvojë të gjatë në turizëm të qëndrueshëm në rajon. Gjatë punëtorisë ajo tregoi shembuj të praktikës së mirë që mund të zbatohen edhe në zonën ndërkufitare.

Aktivitetet promovuese brenda projektit janë duke vazhduar. Për më shumë informacione interesante mund ta ndiqni faqen Facebook të projektit *Accursed Mountains* duke klikuar [këtu](#).



## Harta e deponive e përfunduar

Brenda projektit *Të Bashkuar Kundër Ndotjes*, icily zbatohet nga komuna e Gjakovës, komuna e Petnjicës, OJQ Let's Do It Peja dhe Qendra për Zhvillim Rajonal nga Rozhaja kanë vazhduar me aktivitetet në rajonin ndërkufitar.



Përkatësisht, në Petnjicë gjatë pergaditjes së hartës së deponive, janë identifikuar 26 deponi të egra të madhësive të ndryshme, me sasi të vlerësuara të mbetjeve që tejkalojnë 117 tonë në total. Pas kësaj, aksionet e pastrimit u organizuan me 29 tetor të vitit 2019 me qëllim pastrimin e deponisë ilegale të Savin Bor (afër shkollës fillore) dhe deponisë ilegale Kalica 2 (ngjitur me rrugën rajonale Petnjicë-Rozhajë).



Për më tepër, brenda të njëjtit projekt u organizua një tryezë e rrumbullakët në Pejë (Kosovë) me 7 nëntor të vitit 2019 me palët e interesuara me qëllim të diskutimit të raportit të hartës dhe vlerësimit të deponive të identifikuar të paligjshme. Pjesëmarrësit diskutuan për çështje që lidhen me deponitë ilegale, problemet e qytetarëve dhe menaxhimin e mbeturinave.

## Shtigje të reja të çiklizmit ndërkufitare

Projekti *Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës* po zbatohet nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal – Perëndimi (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës në anën e Kosovës, dhe Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije dhe Organizata e Turistike e Plavës në anën malazeze, të cilët kanë filluar me fushatën promovuese nepërmejt artikujve dhe paraqitjeve të ndryshme në radio stacionin lokal. Për më tepër, gjatë tetorit të vitit 2019 u mbajt një punëtori për mbledhjen e të dhënave GPS me përfaqësues të organizatave të ecjes në natyrë, turizmit dhe çiklizmit nga rajoni i Pejës. Qëllimi i punëtorisë ishte të zhvillojë një plan veprimi në terren në lidhje me mbledhjen e të dhënave GPS, dhe të dhënave të tjera të rëndësishme për shtigjet e reja të ecjes dhe çiklizmit, të parashikuara të zhvillohen përmes projektit. E njëjta veprimtari do të bëhet në Mal të Zi dhe ekipe të ndryshme të grumbullimit të të dhënave GPS do të punojnë në terren gjatë tetorit për të mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme për zhvillimin e hartave dhe alarmeve për shtigje të reja.



All of the implemented activities will lead to the new cross border biking trails that will be completed soon.

## Takimi i 9-të i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Ulqin

Takimi i nëntë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt më 12 nëntor të vitit në Ulqin (Mal i Zi). Takimi u organizua për të diskutuar mbi zbatimin aktiviteteve të mëtejshme në kuadër të IPA Programeve ndërkufitare Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020. Për më tepër, anëtarët e Komitetit të Përbashkët të Projektit vlerësuan cilësinë e aktiviteteve të zbatuara dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2019. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e Zyrës për integritet evropian të Malit të Zi, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi, Ministrisë së Financave të Malit të Zi – Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së (CFU), Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, si dhe të Sekretariatit të Përbashkët Teknik të IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi-Shqipëri dhe Mal i Zi-Kosovë 2014 – 2020.

Fokusi kryesor i këtij takimi ishte miratimi i Raportit Përfundimtar Narrativ të Kontratës së Shërbimit të Asistencës Teknike, diskutimi mbi sistemin e monitorimit dhe treguesit përkatës të projektit, si dhe mbi aktivitetet që lidhen me Thirrjen e Dytë të programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi-Shqipëri dhe Mal i Zi-Kosovë 2014 – 2020 dhe hapat

përgatitore për publikimin e Thirrjen e Tretë në kuadër të këtyre programeve.



## Katër trajnime mbi Ciklin e Menaxhimit të Projekteve u mbajtën në zonat e programeve

Gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 2019, katër trajnime mbi Ciklin e Menaxhimit të Projekteve u mbajtën në Pejë (Kosovë), Bijello Pole dhe Ulqin (Mali i Zi) dhe në Shkodër (Shqipëri). Në trajnime morën pjesë gjithsej 81 pjesëmarrës. Qëllimi i trajnimeve tre-ditore ishte t'u siguronte pjesëmarrësve të gjithë elementët dhe informacionin e nevojshëm në mënyrë që ata të mund të kuptojnë procesin e përgatitjes së granteve, partneritetet ndërkufitare dhe procesin e zhvillimit të projektit sipas qasjes së kornizës logjike. Trajnimi është organizuar posaçërisht për të përgatitur aplikantët e mundshëm për thirrjet e ardhshme brenda të dy programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA  
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

**Andi ÇEKAJ**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**  
Adresa: Agim Ramadani, 36/4, 10 000 Prishtinë, Kosova  
Telefon: +383 38 222 202

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian